



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
KORÇË



Adresa: Shëtitorja "Rilindasit" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82
248944 <http://www.unkorce.edu.al/fedukimit/indexedukimi.html> e-mail:
un.edukim@unkorce.edu.al

QENDRA E EKSELENCËS "FEF"

GUIDË



(Informacion për drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në shërbim)

MISIONI I QENDRËS SË EKSELENCËS “FEF”

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË është një institucion që ka për qëllim organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese për mësuesit në shërbim. Drejtimit kryesore të punës së kësaj qendre përqendrohen në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikatat e zhvillimit profesional të mësuesve etj.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” është një institucion bashkëkohor për kualifikimin e personelit pedagogjik në shkollat e rajonit të Korçës dhe më gjerë. Ajo ofron module trajnimi ku mund ta gjejnë veten shumica e profileve të mësuesve në shërbim, si programe që mbështesin dhe sigurojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përsosjen e saj, zbatime të risive në fushën e mësimdhënies etj. Modulet e kualifikimit pasurohen dhe përsosen vazhdimisht në përputhje dhe në shërbim të ndryshimeve në arsimin parauniversitar.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtorinë arsimore rajonale dhe me zyrat arsimore në rrethe për evidentimin e kërkesave dhe për efektivitetin e programeve trajnuese që ofron ajo. Po ashtu, ajo bashkëpunon dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, të cilat ushtrojnë veprimtari në këto fusha.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” ka një literaturë të specializuar dhe bashkëkohore në ndihmë të kualifikimit të mësuesve të profileve të ndryshme.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” së shpejti do të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi dhe shkëmbim përvoja me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë Shqipërisë.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” e ka selinë në Sallën e videokonferencave të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (auditori 334, kati i tretë), e cila ka një infrastrukturë moderne për kualifikimin e mësuesve. Kjo Qendër i zhvillon veprimtaritë kualifikuese edhe në mjedise të tjera, si: në Bibliotekën e Fakultetit, në Sallën e Amfiteatrit, në sallën e Internetit, në Laboratorin e Gjuhëve të Huaja etj.

QENDRA E EKSELENCËS “FEF” drejtohet nga msc. OLGËR BRAME, i cili merret me gjithë punën organizative të saj, ndërsa trajnues janë pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë mësimdhënieje nga departamentet e Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë, sipas profileve që mbulojnë.

INFORMACIONE TË RËNDËSISHME

Në nenin 2, pika b, të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, thuhet se një nga misionet e arsimit të lartë është që “të ofrojë mundësi për të përfitur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës”. Në nenin 5, pika 2 të po këtij ligji thuhet se “Universiteti siguron arsimim të vazhduar, kualifikime, specializime etj.”

1. Mbështetur në Vendimin nr. 16, datë 24.7.2012 të Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Qendra e Ekselencës “FEF”, ka fituar të drejtën e trajnimit të punonjësve të institucioneve arsimore për **32** module me rreth **90** kredite për të gjithë mësuesit në shërbim (modulet janë përgatitur në bazë të përparësive të fushave për zhvillimin profesional të personelit arsimor).

2. Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore mbështetet në:

I- Ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”:

Kreu IX, Neni 56, Pika 2.

Mësuesi ka të drejtë

c) t’i krijohen mundësi për zhvillim profesional.

Neni 58

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Institucioni arsimor planifikon zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit.

2. Format e zhvillimit profesional janë: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata.

3. Mësuesit dhe drejtorët trajnohen të paktën **3 ditë në vit**.

6. Burimet financiare për trajnimet janë nga kontributi vetjak i punonjësit arsimor.

Neni 59

Kualifikimi i mësuesve

2. Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvijës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

II- Dispozitat Normative në sistemin arsimor parauniversitar

Neni 58. Zhvillimi profesional i mësuesve

Drejtori i shkollës ka përgjegjësi për:

1.b. krijimin e lehtësirave për trajnimin e mësuesve të paktën **3 ditë** gjatë një viti shkollor .

2. Drejtori nxit dhe kontrollon pjesëmarrjen e mësuesve në rrjetet profesionale.

Neni 74

Plani i mësuesit (Vlerësimi nga drejtori/nëndrejtori i shkollës)

Pika 2. Plani përmban këta tregues:

1.a) Numrin e krediteve që mësuesi do të fitojë brenda vitit shkollor.

2. Zgjedhja e moduleve me kreditet përkatëse bëhet me dëshirën dhe sipas interesave të çdo mësuesi në shërbim.

3.Tarifa për çdo kredit është 1000 lekë.

4. Tarifa paguhet në banka të nivelit të dytë pasi merret një faturë arkëtimi nga punonjësjja e zyrës së financës së Universitetit “Fan S. Noli” në auditorin përkatës, në ditën që fillon trajnimi.

5. Të gjitha shërbimet e tjera që ofron Qendra e Ekselencës “FEF” (literatura, printime, fotokopje, shkarkime nga interneti etj.) janë falas.

6. Forma e trajnimit për të gjitha modulet: **trajnim i drejtpërdrejtë** (konsultime, bashkëbisedime), **online** (njoftimet, literatura, pyetjet etj.) dhe **në punën krijuese vetjake** të çdo mësuesi (detyra, projekte etj.)
7. Mësuesit pajisen me **certifikatë zyrtare**, e cila përmban **titullin e modulit dhe kreditet përkatëse**.
8. Aplikimet bëhen **online** në adresën elektronike: olgerbrame@yahoo.com **3 ditë** para datës së datës së parë të sesionit trajnues.
9. Të dhënat për regjistrim i gjeni në shtojcën përkatëse në fund të guidës.
10. Ditën e parë të sesionit trajnues, kualifikimi fillon në **orën 15⁰⁰**, sipas orarit të afishuar në mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

10. Trajnimet zhvillohen në **6 sesione** gjatë vitit shkollor sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Sezoni	Datat
1	Nëntor	21, 22, 23
2	Dhjetor	26, 27, 28
3	Janar	23, 24, 25
4	Shkurt	20, 21, 22
5	Mars	27, 28, 29
6	Prill	24, 25, 26

**LISTA E MODULEVE TË AKREDITUARA DHE KREDITET
PËRKATËSE QË OFRON QENDRA E EKSELENCËS PRANË
FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË TË
UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” KORÇË**

PROGRAMI/MODULI	KODI	NR. I KREDITEVE
Mësimdhënia për të menduarit kritik dhe krijues	M140	4
Kurrikula e gjuhës shqipe në arsimin fillor	M141	3
Mësimdhënia me në qendër nxënësin mbështetur në integrimin e njohurive sintaksore me përdorimin e shenjave të pikësisimit në gjuhën shqipe	M142	2
Metodologji të mësimdhënies së drejtshtqiptimit	M143	4
Metoda, teknika, strategji me në qendër nxënësin në lëndët e Historisë dhe Gjeografisë	M144	4
Planifikimi i mësimdhënies dhe të nxënësit	M145	2
Mësimdhënia dhe nxënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë	M146	2
Përvetësimi i gramatikës dhe fjalorit të gjuhës angleze nëpërmjet lojës	M147	4
Metoda dhe teknika në lehtësimin e mësimdhënies së gramatikës të gjuhës së huaj	M148	2
Strategji të të nxënësit të një gjuhe të huaj	M149	3
Strategji dhe teknika mësimore në profilet e ndryshme të arsimit profesional	M150	3
Strategji për mësimdhënien e leximit	M151	3
Metoda, teknika, strategji mësimore më në qendër nxënësin (Fiziologjia e shqiptimit, probleme, teknika dhe strategji në mësimdhënien e shqiptimit të gjuhës angleze)	M152	2
Koncepte themelore për të kuptuar kurrikulumin	M153	3
Metoda kërkimore gjatë procesit të të nxënësit të një gjuhe të huaj	M154	3
Korniza e të nxënësit në fëmijërinë e hershme. Të përkasësh, të jesh, të bëhesh (Të pasurojmë strategjitë e edukimit parashkollor)	P248	3
Të kuptojmë dhe menaxhojmë sjelljet e fëmijëve me	P249	4

autizëm në klasat gjithëpërfshirëse		
Puna e mësuesit të CP dhe CU me fëmijët me patologji të të folurit	P250	4
Përvetësimi dhe përforcimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore të gjuhës standarde shqipe	K341	2
Informacion për një strukturim sa më efikas të letërsisë antike dhe asaj të huaj	K342	2
Elementë të rinj kurrikularë të edukimit fizik në shkollë	K343	2
Përmbajtja, hartimi dhe zhvillimi i kurrikulës në lëndën e historisë	K344	3
Realizimi i kuptimit të mesazhit gojor ose të shkruar (Veprimtaritë e mësimdhënies dhe të të nxënës)	K345	3
Mësimdhënia funksionale e gjuhës frënge dhe formimi i aftësive komunikuese të nxënësit	K346	3
Përdorimi i TIK në mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës së huaj	TIK 467	3
Portofoli Evropian i Gjuhëve dhe korrigjimi i niveleve të ndryshme të DELF-DALF-it	V517	3
Përgatitja, zhvillimi dhe vlerësimi i materialeve didaktike për mësimdhënien e gjuhës angleze	V518	4
Standardet e vlerësimit brenda kuadrit të përbashkët evropian të referencave për gjuhët	V519	4
Historia , gjeografia dhe të drejtat e njeriut	A623	2
Trashëgimia natyrore dhe mbrojtja e saj në kuadër të mbrojtjes së mjedisit	A624	4
Legjislacioni dhe administrimi në arsimin parauniversitar	D748	2
Normat e etikës dhe sjelljes së mësuesve dhe fryma pozitive në klasë	E 902	2

Stafi i pedagogëve trajnues pranë Qendrës së Ekselencës “FEF”

Prof. dr. Ali Jashari
Prof. as.dr. Aleksandra Piluri
Prof.as.dr. Elona Çeçe
Prof.as.dr. Anyla Saraçi (Maxhe)
Prof. as. Bashkim Jahollari
Prof. as. dr. Pavllo Cicko
Prof. as. dr. Dion Tushi
Doc. Donika Dardha
Doc. Vasilika Pojani
Doc. Mariela Burda
Doc. Robert Stratobërdha
Dr. Erinda Papa
Dr. Benita Stavre

Dr. Lindita Kaçani
Dr. Olsa Pema
Msc. Olger Brame
Msc. Evionda Pylli
Msc. Rezarta Hoxhallari
Msc. Daniela Stoica
Msc. Suela Koça
Msc. Hysnie Hyska
Msc. Alba Kreka
Msc. Ermira Jashiku
Msc. Anjeza Vila
Msc. Orion Ago
Msc. Fabiola Kadi

PËRSHKRIM I SHKURTËR I PËRMBAJTJES SË MODULEVE

Titulli i modulit	Përshkrim i shkurtër
Planifikimi i mësimdhënies dhe i të nxënës	<p>Ky modul synon t'i aftësojë edhe më shumë mësuesit për të ndërtuar plane mësimore me të gjitha elementet që mundësojnë një mësimdhënie produktive, të hartojnë objektiva mësimore sipas taksonomive njohëse, emocionale, psikomotore etj., të cilat ndikojnë në formimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive, nëpërmjet strategjive dhe teknikave me në qendër nxënësin etj.</p> <p>Moduli përmban çështje të tilla, si: domosdoshmëria e planifikimit të mësimdhënies, elementet e përmbajtjes; hartimi i objektivave mësimore të arritjes në të gjitha fushat e taksonomive; metoda, teknika, strategji mësimore me në qendër nxënësin; krijimi i kushteve optimale për një mësimdhënie aktive, krijuese; veprimtari praktike, përvoja shkollore, diskutime etj.</p>
Mësimdhënia dhe nxënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë	<p>Në qendër të këtij moduli është një problem aktual që lidhet me konceptin “nxënës me vështirësi në të nxënë”, duke synuar që mësuesit të njohin llojet e këtyre vështirësive dhe të zhvillojnë strategji dhe teknika për trajtimin e tyre.</p> <p>Moduli lidhet me probleme të tilla, si: kuptimi dhe trajtimi i ndryshueshmërisë; identifikimi dhe klasifikimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë; llojet e vështirësive; karakteristikat e nxënësve me paaftësi në të nxënë dhe trajtimi i tyre; ndërtimi i një bashkëpunimi të dobishëm mes prindërve, mësuesve dhe psikologut shkollor; krijimi i një mjedisi mbështetës dhe nxitja marrëdhëniesve shoqërore në klasë etj.</p>
Kurrikula e gjuhës shqipe në arsimin fillor	<p>Qëllimi i këtij moduli është t'u japë mësuesve në shërbim çelësat e përdorimit të profesionit në kuadër të njohjes dhe përdorimit të parimeve, kritereve, metodave teknikave dhe strategjive që lidhen me mësimdhënien e të nxënësve dhe vlerësimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin fillor.</p>

	Moduli synon t'u qartësojnë pjesëmarrësve në trajnim disa specifika të gjuhës shqipe përmes çështjeve të tilla, si: qasja e re kurrikulare dhe vendi që zë kurrikula e gjuhës shqipe në arsimin fillor në këndvështrimin e kësaj qasjeje; kurrikula e re e gjuhës shqipe; standardet në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin fillor etj.
Legjislacioni dhe administrimi në arsimin parauniversitar	Moduli përmban njohuritë bazë rreth legjislacionit të arsimit parauniversitar dhe synon krijimin e një vizioni të qartë për themelet ligjore mbi të cilat ngrihet ky sistem arsimit. Temat mbi të cilat ndërtohet ky modul trajnimi mbështeten në ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, ndryshimet e bëra në këtë ligj, risitë e tij; në dispozitat normative dhe reflektimin e tyre në punën në shkollë, njohja dhe administrimi i dokumentacionit të nevojshëm shkollor si: plani vjetor i mësuesit, vlerësimi i nxënësve, vetëvlerësimi i mësuesit, portofoli profesional etj. Nëpërmjet bashkëbisedimit sqarohen shumë çështje aktuale të legjislacionit në shkollë.
Mësimdhënia për të menduarit kritik dhe krijues	Zhvillimi i këtij moduli ka për qëllim t'i pajisë mësuesit në shërbim me teknikat kryesore të kurrikulës për të menduarit kritik, e cila po gjen gjithnjë e më tepër zbatim në procesin e mësimdhënies në shkollat tona. Në përfundim të modulit pjesëmarrësit do të jenë të aftë për të kuptuar e interpretuar probleme të rëndësishme që lidhen me mendimin kritik, si: mjedisi për zhvillimin e mendimit kritik, cilat janë teknikat kryesore që zhvillojnë të menduarit kritik në procesin e të mësuarit të lëndëve të ndryshme etj. Moduli realizohet nëpërmjet seancave teorike dhe detyrave praktike ku zbatohen këto teknika.
Trashëgimia natyrore dhe mbrojtja e saj në kuadër të mbrojtjes së mjedisit	Moduli synon të japë konceptin aktual të trashëgimisë natyrore, vlerësimin e saj për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për qëllime ekologjike, mbrojtjen e biodiversitetit, vlerave të tjera të veçanta natyrore etj. Moduli bën vlerësimin bashkëkohor të resurseve, vlerave dhe mënyrave më efikase shkencore të shfrytëzimit të tyre, konceptin aktual të zonës së mbrojtur, klasifikimin e tyre mbi bazën e kritereve të IUCN-së si dhe kriteret e

	ndërtimit të planit të menaxhimit të kategorive të ndryshme të zonave të mbrojtura. Në përfundim do të mundësohet realizimi i një projekt menaxhimi të përbashkët për një zonë të mbrojtur.
Historia, gjeografia dhe të drejtat e njeriut	Moduli ka për qëllim të japë lidhjen mes disiplinave të historisë, gjeografisë dhe të drejtave të njeriut si edhe edukimin e nxënësve për të drejtat nëpërmjet këtyre lëndëve. Sikundër të drejtat e njeriut janë universale dhe edukimi me to kërkon një praktikë të përgjithshme në këtë proces duke përfshirë të gjithë mësuesit sipas disiplinave mësimore. Moduli trajton drejtimit kryesore për të drejtat e njeriut në shkollë, udhëzime dhe sugjerime të integritit të këtyre të drejtave në procesin mësimor të lëndëve, shoqëruar me disa veprimtari praktike në disa tema mësimore në lëndët e historisë dhe gjeografisë.
Koncepte themelore për të kuptuar kurrikulumin	Ky modul përpiqet t'u japë mësuesve një bazë të qëndrueshme njohurish mbi çështjet e kurrikulumit, drejtimit dhe problemet më të fundit që lidhen me këtë fushë. Trajnimi përpiqet të japë konceptet kryesore mbi modelet e kurrikulumit, zhvillimin e kurrikulumit me bazë shkollën, hulumtimet gjatë orës së mësimi. Nëpërmjet bashkëbisedimit dhe diskutimeve, do të jepet një tablo e qartë lidhur me e anët e forta dhe të dobëta të identifikuara në këtë fushë si planifikimi, hartimi dhe zhvillimi i kurrikulës, menaxhimi i kurrikulumit, këndvështrimet e mësimdhënies, përfshirja bashkëpunuese në kurrikulum, etj.
Metoda, teknika, strategji mësimore me në qëndër nxënësin (Fiziologjia e shqiptimit, probleme, teknika dhe strategji në mësimdhënien e shqiptimit të gjuhës angleze)	Moduli i teknikave dhe strategjive në mësimdhënien e shqiptimit të gjuhës angleze synon ndërgjegjësimin e mësuesve për rëndësinë e shqiptimit në komunikim, integrimin e tij në orën e mësimi si pjesë e rëndësishme e aftësive të tjera të gjuhës angleze dhe zhvillimin e aftësive praktike në mësimdhënien e shqiptimit duke hartuar plane dhe orë mësimi model për aspekte të veçanta të tij me qëllim që mësimdhënien e shqiptimit të fitojë të njëjtën rëndësi krahas gramatikës dhe leksikut, për të siguruar një komunikim të suksesshëm. Këto synime do të realizohen nëpërmjet njohjes së problemeve dhe qëndrimeve bashkëkohore, duke evituar

	kështu vështirësitë në mësimdhënien e tij.
Përgatitja, zhvillimi dhe vlerësimi i materialeve didaktike për mësimdhënien e gjuhës angleze	Trajnimi synon që t'u mësojë mësuesve të gjuhës angleze në shkollat fillore, 9-vjeçare dhe të mesme, si të vlerësojnë librat/ metodat e gjuhës angleze dhe të përzgjedhin ato që përshtaten më mirë me qëllimet e tyre. Numri i metodave të gjuhës angleze është gjithnjë në rritje dhe për këtë arsye mësuesit e gjuhës angleze duhet të kenë kritere shumë të qarta vlerësimi kur zgjedhin një metodë/kurs ose material mbështetës. Ky trajnim u ofron mundësinë për të përvetësuar dhe zbatuar këto kritere, nëpërmjet prezantimeve, demonstrimeve por kryesisht nëpërmjet ushtrimeve praktike, konkrete, duke punuar me metoda që tashmë ata përdorin me nxënësit e tyre në klasë.
Standardet e vlerësimit brenda kuadrit të përbashkët evropian të referencave për gjuhët	Metodat e vlerësimit, ashtu si ato të mësimdhënies, kanë ndryshuar gjatë kohës. Kurrikulat në sistemin arsimor shqiptar kanë ndryshuar dhe u përshtatën me një model i cili e kupton shkencën si një proces aktiv, duke inkurajuar të menduarin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive. Kjo është arsyeja pse strategjitë e vlerësimit duhet të përqëndrohen në përafrimin më të ngushtë me strategjitë e mësimdhënies të përdorura me nxënësit. Moduli jep prezantimin e rubrikave si mjete të vlerësimit të nxënësve në shkollat fillore, 9-vjeçare, por edhe në gjimnaze, përkufizimin, pjesët e një rubrike si dhe fazat kryesore në procesin e ndërtimit të rubrikës duke demonstruar se si rubrikat mund të bëhen metoda standarde të vlerësimit
Metoda dhe teknika në lehtësimin e mësimdhënies së gramatikës së gjuhës së huaj	Mësimdhënia e gramatikës është gjithmonë sfiduese për shkak të nivelit të nxënësve. Nga ana tjetër, edhe mësuesit vetë janë të ndryshëm në atë që disa prej tyre i mëshojnë më shumë gramatikës sesa komunikimit në procesin e mësimdhënies. Disa të tjerë i japin më shumë rëndësi komunikimit sesa formave gramatikore. Ky modul do t'u vijë në ndihmë mësuesve për t'i bashkërenduar të dyja. Njëkohësisht do t'i ndihmojë mësuesit të vlerësojnë materiale të ndryshme për mësimdhënien.

	Moduli do t'i ndihmojë mësuesit e gjuhës së huaj në procesin e mësimdhënies së gramatikës në mënyrë që ky proces të jetë sa më efektiv dhe domethënës për nxënës me nivele të ndryshme.
Përvetësimi dhe përforcimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore të gjuhës standarde shqipe	Moduli përpiqet t'u vijë në ndihmë mësuesve në shërbim për të rritur kulturën gjuhësore dhe për të zbatuar standardin e gjuhës shqipe, duke zgjeruar njohuritë e tyre mbi gramatikalitetin e formave gjuhësore të shqipes standarde, shpjegimin e rregullave gramatikore, dallimin e formave gramatikore nga ato jogramatikore etj. Mësuesve u ofrohet një model sa më i plotë i rregullave drejtshkrimore në kushtet e zhvillimit të shqipes gjatë njëzet viteve të fundit. Mësuesit do të njihen me mënyra dhe teknika që do të aftësojnë nxënësit të shkruajnë drejt dhe pa gabime shqipen standarde, duke përforcuar disa prej rregullave drejtshkrimore të saj.
Strategji për mësimdhënien e leximit	Ky modul është hartuar për t'u ardhur në ndihmë mësuesve në shërbim të ciklit 9- vjeçar dhe të mesëm në zhvillimin e metodave dhe aftësive të veçanta të nevojshme për mësimdhënien me efikasitet të leximit, gjë që do të përmirësojë të nxënit nëpërmjet kurrikulës. Këto metoda do të përdoren si mjet për të menduarit dhe të nxënit kritik në të gjitha fushat e përmbajtjes. Ky modul do të përfshijë strategji për mësimdhënien e teksteve artistike, informative, narrative, të zhvillimit të fjalorit, strategji reflektive, strategji shkrimi të cilat ndërtojnë dhe zgjerojnë kuptimin, vlerësime, si dhe planifikim mësimesh strategjike duke vendosur një strukturë për mësimdhënien e leximit nëpërmjet hetimit të praktikave bashkëkohore.
Strategji dhe teknika mësimore në profilet e ndryshme të arsimit profesional	Anglishtja për synime specifike njihet ndryshe edhe si mësimdhënia e anglishtes së profesioneve me në qendër nxënësin. Ajo plotëson nevojat e mësuesve të shkollave profesionale të cilët japin mësim gjuhën angleze në fusha specifike, të tilla si shkenca, teknologjia, mjekësia, media, apo anglishtja për qëllime akademike. Ky modul rekomandohet për ata mësues të cilët dëshirojnë të mësojnë si të ndërtojnë kurset dhe

	<p>programet në një hapësirë të specializuar si anglishtja e biznesit, e arteve, e medias, anglishtja akademike, ajo ligjore, e shkencës dhe e teknologjisë, duke synuar përgatitjen e materialeve mësimore në profilet e ndryshme të arsimit profesional dhe vlerësimin e planit mësimor në fushën e tyre profesionale.</p>
<p>Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës së huaj</p>	<p>Moduli i përdorimit të TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës së huaj synon në ngritjen profesionale të mësuesve, duke rritur mundësitë dhe rolin e tij në procesin mësimor. Duke trajtuar aspekte të përdorimit të procesorëve të fjalës dhe mundësive të shfrytëzimit të tyre në funksion të mësimdhënies së gjuhës së huaj, jepen modele të suksesshme të veprimtarive mësimore. Aspekt tjetër i rëndësishëm i punës me mjetet e TIK-ut janë ëbsite-et dhe përdorimi i duhur i tyre për qëllime gjuhësore. Mësuesit njihen me projekte përmes internetit duke i mëshuar rolit të pazëvendësueshëm të tyre në përvetësimin e shprehive gjuhësore. Me interes do të jetë edhe paraqitja e disa koncepteve themelore të mësimdhënies elektronike.</p>
<p>Metoda, teknika, strategji me në qendër nxënësin në lëndën e historisë dhe gjeografisë</p>	<p>Moduli sjell në vëmendje përdorimin dhe përvetësimin e metodave të reja të mësimdhënies në disiplinat e historisë dhe gjeografisë për të nxitur të mësuarin kritik dhe krijues tek nxënësit. Shtyllat kryesore në të cilat mbështetet ai lidhen me fushat e studimit, metodat dhe teknikat në lëndët e gjeografisë dhe historisë përdorimin e hartës, përsëritjet, testet etj. Metodatat e mësimdhënies do të konkretizohen me shembuj në disiplinat përkatëse duke përdorur për secilën fazë të mësimin metodën e duhur për një mësimdhënie sa më produktive. Gjatë trajnimit do të jepen modele të ndryshme të çështjeve që do diskutohen. Njohuritë do të ilustrohen me shembuj edhe nga ana e pjesëmarrësve në trajnim.</p>
<p>Normat e etikës dhe sjelljes së mësuesve dhe fryma pozitive në klasë</p>	<p>Moduli për sjelljen e mësuesve dhe frymën pozitive në klasë ndalet në çështje dhe nënçështje që kanë të bëjnë me krijimin e një klime të përshtatshme për të zhvilluar një orë mësimi sa më produktive në klasë. Është një</p>

	<p>modull i cili sugjeron të përforcojë metoda për nxitjen e frymës pozitive për mësuesit e lëndëve të ndryshme. Shtyllat kryesore në të cilat mbështet trajnimi lidhen me kodin e etikës së mësuesit, sjelljen e mësuesve dhe frymën pozitive në klasë.</p> <p>Në një pjesë të modulit shpalosen të drejtat e fëmijëve në bazë të konventës së të drejtave të tyre të cilat duhet të jenë pjesë e pandashme në procesin e mësimdhënies.</p>
Metodologji e mësimdhënies së drejtshqiptimit	<p>Duke qenë se shqiptimi është pjesë e aftësive të mësuesit, ai lidhet me mësimdhënien e gjuhës, por dhe me komunikimin me nxënësit. Ky modul synon të aftësojë mësuesit në mësimdhënien e elementeve fonetike dhe fonologjike të gjuhës, duke vënë theksin në përdorimin e saj për qëllime komunikative, për të realizuar përvetësimin e standardit në shqiptim, si një veçori që paraqet shumë vështirësi.</p> <p>Moduli përqendrohet në integrimin e njohurive mbi sistemin fonetik dhe fonologjik të shqipes standarde dhe dialekteve dhe përdorimin e mjeteve audio-vizive dhe programeve kompjuterike për përvetësimin e normës drejtshqiptimore në mësimdhënien e gjuhës amtare në ciklin parashkollor dhe fillor dhe në leximin e teksteve sipas përkatësisë dialektore në AMU dhe AML.</p>
Puna e mësuesit të CP dhe të CU me fëmijët me patologji të folurit	<p>Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë nevojat e fëmijëve me dëmtime të të folurit, gjuhës dhe komunikimit nga një varg perspektivash dhe do të shqyrtojnë se si mësuesit dhe terapistët gjuhësorë mund të punojnë së bashku në klasa gjithëpërfshirëse në kontekst institucional. Duke argumentuar modulet në bazë të arsimimit akademik special, edukimit përfshirës dhe studimeve mbi gjuhën dhe komunikimin, pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri dhe aftësi për të përmbushur nevojat e këtyre fëmijëve. Sipas vlerësimit të nevojave të mësuesve, pjesëmarrësit do të njihen me aftësitë kryesore të dallimit, ndërhyrjes dhe përpjekjes për përmirësim të kësaj problematike tek fëmijët që i mbartin këto vështirësi e që i shfaqin vazhdimisht ato, në përfshirjen normale në klasë gjatë procesit mësimor.</p>
Korniza e të nxënit në	Moduli synon të ndihmojë mësuesit pjesëmarrës që

<p>fëmijërinë e hershme “Të përkasësh, të jesh, të bëhesh” (Të pasurojmë strategjitë e edukimit parashkollor)</p>	<p>punojnë në sistemin arsimor me fokus fëmijërinë e hershme, të pasurojnë strategjitë e edukimit që përdorin aktualisht duke siguruar tek fëmijët parashkollorë, mundësitë për të arritur potencialin maksimal të tyre, si edhe të zhvillojnë bazën për sukses në procesin e të nxënësve të mëvonshëm. Theksi specifik vendoset te të nxënësve e bazuar në lojë, te rëndësia e komunikimit dhe gjuhës si dhe zhvillimi social e emocional, në moshën parashkollorë. Kjo kornizë vjen e peceptuar si e tillë, bazuar në faktin se fëmijëria e hershme është moshë e zhvillimit dhe të nxënësve, e cila vendos natyrshëm bazat për një të nxënë të suksesshëm në të ardhmen.</p>
<p>Të kuptojmë dhe menaxhojmë sjelljet e fëmijëve me autizëm në klasat gjithëpërfshirëse</p>	<p>Me rritjen e numrit të nxënësve me autizëm, të cilët janë përfshirë në klasa normale në arsimin gjithëpërfshirës, mësuesit kanë nevojë të dinë se si të menaxhojnë sjelljet negative që i shoqërojnë këta fëmijë. Mësuesit do të njihen me një paketë të plotë të njohurive teorike, të aftësive praktike që lidhen me nevojat sensore tek këta fëmijë dhe sjelljet pasojë të tyre, të kuptojnë rolin e tyre në modelin e terapisë së integritimit sensor dhe si mund të ndihmojnë nxënësit me autizëm të zëvendësojnë sjelljet sensore jofunksionale, me sjellje më tepër funksionale , të përshtatshme për mjedisin e klasës. Moduli është bazuar mbi kërkimet për nevojat e të nxënësve dhe teknikat për zhvillimin e sjelljes përshatëse për to.</p>
<p>Përvetësimi i gramatikës dhe fjalorit të gjuhës angleze përmes lojës</p>	<p>Moduli mundëson që mësuesit e gjuhës së huaj të njihen me një larmi lojrash që mundësojnë praktikimin dhe përvetësimin e njësive leksiko-gramatikore në nivele të ndryshme gjuhësore (nga niveli A1 tek B2), në klasa të mëdha dhe me diversitet të formimit kulturor, duke u aftësuar në përdorimin e këtyre veprimtarive, të cilat ndihmojnë nxënësit të vërejnë dhe përdorin format e reja gjuhësore, të nxitin ndërveprimin mes tyre dhe të sjellin një atmosferë argëtuese në klasë.</p>
<p>Strategji të të nxënësve të një gjuhe të huaj</p>	<p>Moduli u jep mësuesve njohuritë e nevojshme për të plotësuar trinomin gjuhë –nxënës –mësues me të cilin përballet çdo ditë në përvojën e mësimdhënies. Njohuritë e marra në metodologjinë e mësimdhënies</p>

	<p>nuk mund të jenë asnjëherë të plota nëse një mësues nuk di se si ta ndihmojë nxënësin të mësojë një gjuhë të huaj duke i kushtuar vëmendjen e duhur mësimdhënies me qendër nxënësin. Duke njohur nevojat, mënyrat dhe strategjitë që ky i fundit mund të përdorë gjatë përvetësimit të një gjuhe të huaj, mësuesi do të jetë i aftë të përshtatë metodikën e tij të punës gjatë këtij procesi dhe të mundohet të gjejë apo krijojë hapësirën e duhur në planin e tij mësimdhënës për shpjegimin e strategjive të të nxënit.</p>
<p>Informacione për një strukturim sa më efikas të letërsisë antike dhe asaj të huaj</p>	<p>Ky modul synon në një strukturim sa me mbresëlënës dhe efikas të njohurive që kanë të bëjnë me letërsinë e huaj në përgjithësi, me autorë, rryma dhe mënyra letrare, me llojet e zhanreve të krijuara, me marrëdhëniet, të përbashkëtat, veçantitë etj, të cilat nuk janë vetëm një rifreskim i njohurive, por edhe një analizë dhe sintezë e shpejtë e gjithçkaje që ka të bëjë me këtë letërsi, në mënyrë që esenca të zotërohet sa më mirë nga mësimdhënësit dhe sidomos të jepet në një mënyrë sa më të përshtatshme dhe efikase.</p>
<p>Mësimdhënia me në qendër nxënësin mbështetur në integrimin e njohurive sintaksore me përdorimin e shenjave të pikësimit në gjuhën shqipe</p>	<p>Tërësia e shenjave të pikësimit dhe rregullat e përdorimit të tyre përbëjnë pikësimin e një gjuhe. Pamja e plotë e pikësimit të një gjuhe përcaktohet nga struktura e saj sintaksore. Moduli përpiket t'u vijë në ndihmë mësuesve për të përcjellë njohuri për pikësimin, duke u nisur nga parimi sintaksor, përmes strategjive me në qendër nxënësin, duke zgjeruar njohuritë e tyre mbi përdorimin në ndërtimet sintaksore të pikës, pikëpyetjes, pikëçuditjes, vizës, dy pikave, kllapave, thonjzave, presjes etj.</p>
<p>Realizimi i kuptimit të mesazhit gojor ose të shkruar. Veprimtaritë e mësimdhënies dhe të nxënit.</p>	<p>Moduli synon të përcojë konsiderata teorike dhe të zhvillojë më tej aftësitë praktike të mësuesve për arritjen tek kuptimi i mesazhit gojor ose të shkruar dhe veprimtaritë e mësimdhënies dhe të të nxënit. Objektivat dhe përmbajtja e këtij moduli lidhen me gjuhën e folur dhe nevojat e nxënësve, zhvillimin e aftësive perceptuese të nxënësve, strategjitë e arritjes tek kuptimi nga gjuha e folur te gjuha e shkruar etj. Pjesëmarrësit do të njihen me strategjitë e arritjes tek</p>

	kuptimi nga gjuha e shkruar dhe disa teori e tipe veprimtarish të të nxënit.
Elementë të rinj kurrikularë të edukimit fizik në shkollë	<p>Ky modul pajis pjesëmarrësit me njohuri për elementët e rinj kurrikularë në programet e edukimit fizik dhe konceptet bashkëkohore për organizimin dhe zhvillimin e edukimit fizik në shkollë, duke i dhënë një trajtim bashkëkohor kompetencave dhe objektivave lëndore në fushën e edukimit fizik dhe sporteve.</p> <p>. Hartimi i testeve në lëndën e edukimit fizik dhe metodologjia e vlerësimit të nxënësve në këtë lëndë,plani grafik dhe tematik, janë aspekte të rëndësishme që u vijnë në ndihmë mësuesve që zhvillojnë lëndën e edukimit fizik dhe sporteve.</p>
Mësimdhënia funksionale e gjuhës frënge dhe formimi i aftësive komunikuese të nxënësit	<p>Moduli synon të përçojë konsiderata teorike dhe të zhvillojë më tej aftësitë praktike të mësuesve për një mësimdhënie funksionale dhe aftësi komunikuese të nxënësve, duke u njohur me objektivat dhe përmbajtjen e këtij orientimi didaktik, identifikimin e nevojave të nxënësve, analizën e funksioneve të komunikimit, faktorët që marrin pjesë në procesin e komunikimit etj. Pjesëmarrësve u jepen për diskutim disa modele komunikuese, duke operuar më pas edhe me mikrokompetencat ose përbërësit e aftësisë komplekse të komunikimit edhe në sfondin kulturor.</p>
Përmbajtja, hartimi dhe zhvillimi i kurrikulës në lëndën e historisë	<p>Kurrikula si fushë studimi është vendimtare jo vetëm për mbarëvajtjen e shkollave, por edhe të gjithë shoqërisë. Në kuptimin e ngushtë të fushës ajo nënkupton një listë lëndësh që duhet të mësohen në shkollë, ndërsa në kuptimin e gjerë ajo ndikon si tek ata që merren me këtë fushë, arsimtarët, nxënësit, specialistët e kurrikulës, ashtu dhe tek shoqëria në përgjithësi. Kurrikula e lëndës së historisë reflekton në thelb proceset e zhvillimit historik. Në këtë kuptim ajo është gjithçka: është planifikim, dokumentacion, strategji, teknologji e mësimdhënies, vlerësim, marrëdhënie, Nëpërmjet trajnimit, mësuesit pjesëmarrës do të njihen pikërisht me të gjitha këto aspekte që përfshin në vetvete kurrikula e historisë.</p>

**Portofoli Evropian i
Gjuhëve dhe korrigjimi i
niveleve të ndryshme të
DELF-DALF-it**

Realizimi i këtij moduli lidhet me përforcimin e njohjes së Kuadrit të përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët për të harmonizuar praktikat vlerësuese të kritereve të vlerësimit për DELF-DALF-in tek mësuesit e gjuhës frënge. Me daljen në skenë të Portofolit Evropian të Gjuhëve, nxënësi ka interes të njohë vlerësimin e tij jo vetëm sipas sistemit aktual të vlerësimit me notë, por gjithashtu të jetë në gjendje të njohë nivelin e tij në një kuadër më të gjerë të vlerësimit sipas kritereve të vendosura nga Kuadri i përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët. Kjo do të nxisë tek nxënësit një interes më të madh për ta mësuar gjuhën më mirë dhe për t'u ushtruar më shumë në të folur, në të shkruar e në dëgjim.

Shtojcë :

INFORMACIONI QË DUHET TË DËRGONI PËR T'U REGJISTRUAR

EMRI, MBIEMRI _____

SHKOLLA KU PUNONI _____

PROFILI _____

VITET NË ARSIM _____

KONTAKT (Nr. tel . ose e-mail _____

MODULI OSE MODULET PËR TË CILAT DO TË REGJISTROHENI
(KODI DHE TITULLI I MODULIT) _____

APLIKUESI

SHËNIM: FORMULARI TË PLOTËSOHET ME SHKRONJA SHTYPI.